

LINK: <http://www.interreg-danube.eu/approved-projects/agrigo4cities>

Buxheti total AGRIGO4CITIES – 1,474,190.20 €

Buxheti i Komunës së Ulqinit – 99,316.50 €

Kontributi IPA – 84,419.02

ENI – 0

AGRIGO4CITIES - Bujqësia urbane për ndryshimin e qyteteve: modelet qeverisëse për kapacitete më të mira institucionale dhe përfshirje sociale – AGRIGO4CITIES

Në kohët e fundit, nevojat dhe sfidat kryesore që lidhen me sistemet e qeverisjes në rajonin e Danubit kanë të bëjnë me zvogëlimin e kapaciteteve institucionale publike në mënyrë që të arrihet një pjesëmarrje më e gjërë në proceset vendimmarrëse. Mungesa e mekanizmave që ka për qëllim një pjesëmarrje më të gjërë publike po kontribuon në uljen e motivimit të njerëzve për t'u angazhuar në qeverisje dhe administratë, sepse ata ndjehen të larguar nga agjendat politike, sociale dhe ekonomike dhe nuk janë kompetent për të vepruar si homologë ekuivalent dhe një nxitës i konsiderueshëm i "ndryshimit". Si rrjedhojë e kësaj, distanca në mes qytetarëve dhe autoriteteve publike në të gjitha nivelet është duke u rritur dhe duke çuar në rritjen e mosbesimit dhe mungesës së pjesëmarrjes së publikut, veçanërisht në mesin e komuniteteve më të pafavorizuara e në rrezik përjashtimi, siç janë komunitetet e varfra, të papunët, të pastrehët, romët, të moshuarit, gratë dhe të rinjtë. Pabarazitë sociale dhe ekonomike reflektohen në cilësinë e varfër të jetës urbane.

Për të kapërcyer këto sfida, Projekti AgriGo4Cities ka për qëllim të përdorë bujqësinë pjesëmarrëse Urbane dhe Periurbane (UPA) si një metodë e fuqishme dhe e re për të përmirësuar kapacitetet institucionale publike në mënyrë që të trajtojë përjashtimin socio-ekonomik të grupeve vulnerabël / të marginalizuar dhe të stimulojë zhvillimin e qëndrueshëm urban në rajonin e Danubit. Për këtë arsye projekti synon të zhvillojë metodologji inovative të planifikimit të pjesëmarrjes më të gjërë publike dhe ta integrojë atë në proceset vendimmarrëse.

Kjo metodologji do të përmirësojë kapacitetet e administratorëve publikë ashtu që do të përfshijë aktorët relevantë dhe shoqërinë civile në qeverisje dhe pjesëmarrje publike. Bashkëpunimi i intensifikuar do të rrisë besimin reciprok dhe do të nxisë forcimin e përfshirjes socio-ekonomike të grupeve vulnerabël / të marginalizuara. Reduktimi i pabarazive sociale dhe ekonomike do të çojë në një zhvillim më të qëndrueshëm të lagjeve të pafavorizuara. Në këtë mënyrë, duke zbatuar një qasje me më shumë nivele transnacionale, ambicia e projektit AgriGo4Cities është të bëhet një lider në rajonin e Danubit.

